



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Prill 2026

Data 29.04.2026 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.03.2026 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2026.
- 3.Projekt vendimin për "Disa ndryshime në VKB Nr.14 datë 24.02.2026 "Për ndryshimin e VKB nr.74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028".
- 4.Projekt vendimin për "Disa ndryshime në VKB Nr.14 datë 24.02.2026 "Për ndryshimin e VKB nr.74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028",numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për vazhdimësinë dhe vlerën e perfitimit për z. Bujar Ferizolli në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë"
- 6.Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Pjeter Gjoni në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush".
- 7.Projekt vendim për miratimin e "Programit të Ri të Transparencës" për Bashkinë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për njohjen si posedues jopronarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me VKM Nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës"
- 9.Projekt vendim për miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurrimit të pasurisë nr.1/29 Zk 8598, objektin e quajtur "Tregu "Vau dejës, me sipërfaqe prej 800 m2, nga kjo 663 m2 "Ndërtesë" dhe 137 m2 "Truall funksional", prone e Bashkisë Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: "Përveprimtari tregtare"
- 10.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 29.04.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i



këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 18 këshilltarë, (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Roberto Trushi, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija.) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z. Ervis Shimaj - kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët nuk kishin diçka për të shtuar. Hidhet në votim rendi i ditës: **Miratohet rendi i ditës me 18 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Roberto Trushi, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija.)

Z. Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.03.2026 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 26.03.2026 nga Z. Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Roberto Trushi, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija.)

Z. Ervis Shimaj lexon piken 2 të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2026.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se propozojmë të përfitojmë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2026 familje 125, me 399,533 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Mars 2026 janë shpallur fitues, 866 familje, me fond 6,660,189 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 399,611 lekë.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 2 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Kastriot Shkjau, Edona Molla, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Roberto Trushi, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija.)



Z.Ervis Shimaj lexon piken 3 të rendit të ditës:

Projekt vendimin për "Disa ndryshime në VKB Nr.14 datë 24.02.2026 "Për ndryshimin e VKB nr.74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi- drejtore e zyres Financë –Buxhetit, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton për projekt vendimin e paraqitur: Është konstatuar që për projektin "Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat +mbikqyrje+ kolaudim" me kod projekti 1570873, fondet buxhetore janë të shpërndara aktualisht në tre programe buxhetore konkretisht 09120 Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë, 04520 Rrjeti Rrugor Rural dhe programi 08130 Sport dhe Argëtim, ku tek ky i fundit duhet të jenë fondet buxhetore për këtë investim. Me anë të këtij projekt vendimi jemi angazhuar për të bërë këtë sistemim duke kaluar të gjitha fondet buxhetore të programit 09120 dhe 04520 të këtij projekti tek programi 08130 për realizimin e tij duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore sipas tabelës nr. 1 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi. Gjithashtu në këtë tabele është paraqitur rishpërndarja e buxhetit për paga dhe sigurime nga programi 01110 tek programi 06260 që i përket Sherbimeve Publike, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të pagave që është bërë në përputhje me VKM Nr.87 datë 06.02.2026 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike" të Ndryshuar. Fondet buxhetore të prekura në zbritje për programin buxhetor 01110 janë prekur me faktin e mjaftueshmërisë së fondeve për këtë program, fonde të trashëguar të papërdorura nga vitet e kalura.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 3 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Besmir Kapaj,Mark Bisha,SanijeSalja,RobertoTrushi,ArsenMehmeti,AlbinaLivadhi,OrnelaLleshi,RregjinëShelqetja, Vijoleta Markolaj,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija.)

Në këtë moment të mbledhjes bëhet pjesë edhe këshilltari Z.Samed Hasmegaj, i cili kishte njoftuar më parë për vonesen e pjesëmarrjes.Numri i këshilltarëve prezent në mbledhje bëhet 19 këshilltarë.

Z.Ervis Shimaj lexon piken 4 të rendit të ditës:

Projekt vendimin për "Disa ndryshime në VKB Nr.14 datë 24.02.2026 "Për ndryshimin e VKB nr.74 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028",numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi- drejtore e zyres Financë –Buxhetit, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton për projekt vendimin e paraqitur: Paraqitet rishpërndarja e buxhetit ndërmjet programve me kapitull 01 për paksimin e zërit të investimit me emertim "Studim



projektim rrjeti i dyte ujites Njesia Admnsitrative Bushat", me kod projekti 1570888 dhe kod programi 04260 dhe në shtesë buxheti për investimin me emertim "Sistemim, asfaltim rrugët e brendshme Kosmaç" me kod projekti 1570830 dhe kod programi 04520 Rrjeti Rrugor Rural, projekt ky që është pjese e listes së prioriteteve për Vitin 2026 të miratuara me VKB nr.76 datë 23.12.2025 me Shprehje Ligjshmërie Nr.884/1 prot. Datë 07.01.2026.Zbritja e fondeve buxhetore nga zëri i investimit "Studim projektim rrjeti i dyte ujites Njesia Admnsitrative Bushat", me kod projekti 1570888, vjen si rezultat i vlersimeve te perditesuara te brendshme te institucionit, mbi mundesite e realizimit te ketij investimi, i cili parashikohet të realizohet me fondete qeverisë.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 4 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Besmir Kapaj,Mark Bisha,SanijeSalja,RobertoTrushi,ArsenMehmeti,AlbinaLivadhi,OrnelaLleshi,RregjinëShelqetja, Vijoleta Markolaj,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Samed Hasmeqaj).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 5 të rendit të ditës:

Projekt vendim për vazhdimësinë dhe vleren e përfitimit për z. Bujar Ferizolli në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Dajana Lleshi-pergjegjese sektorit strehimit social, Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se Komisioni i Strehimit, realizoi mbledhjen në datën 12.03.2026,ku u be shqyrtimi i dokumentacionit të plotë dhe kontrataes së qirasë noteriale për banorin Bujar Ferizolli.Nga vlersimi social ekonomik vërehet se kjo familje jeton me Ndhimë Ekonomike dhe si rrjedhoje nuk mund të perballoje një shtepi me qira. si dhe shpenzimet jetike.Komisioni i strehimit e shikoj të arsyeshme për asisituat si përfitues të programit të strehimit subvencioni i qirasë në tregun e lire.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 5 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Besmir Kapaj,Mark Bisha,SanijeSalja,RobertoTrushi,ArsenMehmeti,AlbinaLivadhi,OrnelaLleshi,RregjinëShelqetja, Vijoleta Markolaj,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Samed Hasmeqaj).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 6 të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Pjeter Gjoni në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Marketa Lleshaj-specialiste e zyres strehimit social,Bashkia Vau Dejës e cila spjeron se mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social. Bashkia Vau Dejës të Z.Pjeter Gjoni si dhe pas vlerësimit të situates se tij familjare.ekonomike dhe shëndetsore, konstatohet se Z.Pjeter Gjoni është një i moshuar që aktualisht jeton tek nipi i tij,



i cili është shprehur se nuk mund ta mbaje me. Duke marrë parasysh moshën gjendjen shëndetsore, vetminë dhe mungesën e kujdesit familjar, propozohet akomodimi i tij në Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush"

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 6 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Kastriot Shkja, Edona Molla, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Roberto Trushi, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Samed Hasmeqaj).

Z. Ervis Shimaj lexon piken 7 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e "Programit të Ri të Transparencës" për Bashkinë Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj sqaron se Bashkia Vau i Dejës ka miratuar programin e transparencës nëpërmjet VKB nr.29, datë 29.04.2024, me afat rishikimi 4 (katër) vjet. Në vijim rezultojnë që organi kompetent Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, nëpërmjet Urdhërit nr.280, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", ka vendosur: Miratimin e Programit Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, bashki dhe këshilla qarqesh. Në kushtet ku Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka shfuqizuar urdhërin nr.211, datë 10.9.2018, është e nevojshme që nga ana jonë të shfuqizohet VKB nr.29, datë 29.04.2024 dhe të vijohet me miratimin e programit të transparencës sipas materialit bashkëngjitur urdhërit nr.281, datë 30.12.2025.

Z. Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.** Këshilltarët që votuan pro piken e 7 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Franga Kola, Elton Frashnaj, Kastriot Shkja, Edona Molla, Besmir Kapaj, Mark Bisha, Sanije Salja, Roberto Trushi, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Ornela Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Vijoleta Markolaj, Vjollcë Zagani, Martin Mardoda, Mirela Vasija, Samed Hasmeqaj).

Z. Ervis Shimaj lexon piken 8 të rendit të ditës:

Projekt vendim për njohjen si posedues jopronarë për aplikimet e bëra në disa zona të miratuara me VKM Nr.780 datë 19.12.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Vau Dejës"

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj. Marinela Deda-Drejtoreshë e zyrës juridike- Bashkia Vau Dejës e cila shpjegon për këshilltarët se në zbatim të procedurave të ndjekura nga grupi i punës i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ngritur me urdhrin e Kryetari të Bashkisë Vau Dejës nr.08, datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës me qëllim ndjekjen e procesit administrativ të kërkesave të subjekteve të ndryshëm kërkuar, për tu njohur si "posedues", "jo pronarë, pasi u njohën me aplikimet e bëra nga subjektet e interesuara në portalin e-albania, mbylles së korrespondencës zyrtare me ASHK dhe ATP, verifikimit në terren në rastet e mungesës së dëshmitarëve, dhe realizimit të afishimit 45 ditor në webin e faqes zyrtare të bashkisë si dhe pranë cdo njësie administrative ku ndodhet prona, paraqiten bashkëngjitur projekt-vendimit relacioni shpjegues përmbledhës për rastet e kualifikuara për fazën e parë të mbylles së afishimeve publike.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 8 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Besmir Kapaj,Mark Bisha,SanijeSalja,RobertoTrushi,ArsenMehmeti,AlbinaLivadhi,OrnelaLleshi,RregjinëShelqetja, Vijoleta Markolaj,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Samed Hasmegaj).

Z.Ervis Shimaj lexon piken 9 të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurrimit të pasurisë nr.1/29 Zk 8598, objektin e quajtur "Tregu "Vau dejës, me sipërfaqe prej 800 m2, nga kjo 663 m2 "Ndërtesë" dhe 137 m2 "Truall funksional", prone e Bashkisë Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: "Përveprimtari tregtare"

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Ndoc Baqli-përgjegjës i sektorit aseteve, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon se objekt i këtij Projekt Vendimi është dhënia në përdorim e pasurisë nr 1/29, Zk nr 8598, objekti i quajtur "Tregu", ndodhur në qendër të qytetit Vau Dejës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 800 m2, nga e cila 663 m2 ndërtesë dhe 137 m2 truall funksional, e cila referuar përcaktimeve të mësipërme mbi afatet, mund të jepet me qira me afat deri 20 vjet. Ky objekt është transferuar "në pronësi", të Bashkisë Vau Dejës, me VKM-në nr 1423, datë 10.10.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut të Shkodrës", me funksion "zhvillim ekonomik", "Në pronësi".Është aplikuar pranë ASHK-së DV Shkodër, për regjistrimin dhe nxjerrjen e çertifikatës së pronësisë për këtë pasuri, procedura e së cilës është "në proces". Dhënia në përdorim do të bëhet sipas procedurave të konkurimit publik.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro piken e 9 të rendit të ditës: ,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Besmir Kapaj,Mark Bisha,SanijeSalja,RobertoTrushi,ArsenMehmeti,AlbinaLivadhi,OrnelaLleshi,RregjinëShelqetja, Vijoleta Markolaj,Vjollcë Zagani,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Samed Hasmegaj).

Pika 10:Të ndryshme:Znj.Sanije Salja ngre shqetësiminse në fshatin Stajka në një lagje mungojn tabelat me emërtimet e rrugëve dhe në një lagje tjeter megjithese ka shum pak banorë, mungon ndriçimi i rrugëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit, Mbledhja e Kshillit Bashkiak e datës 29.04.2026,

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- | | |
|-----------------------------|---------------------------|
| 1. <u>Enis Shimal</u> | 16. <u>Martin Mardoda</u> |
| 2. <u>Blau Frango</u> | 17. <u>Roberto Trush</u> |
| 3. <u>Envera Kolo</u> | 18. <u>Myllëri Logani</u> |
| 4. <u>Ornela Lleshi</u> | 19. <u>Samed Khamaj</u> |
| 5. <u>Elton Frashj</u> | 20. _____ |
| 6. <u>Arsen Mehmeti</u> | 21. _____ |
| 7. <u>Violeta Morkalaj</u> | 22. _____ |
| 8. <u>Regjina Shkëqaja</u> | 23. _____ |
| 9. <u>Mastriot Shkëqaja</u> | 24. _____ |
| 10. <u>Besmir Kopaj</u> | 25. _____ |
| 11. <u>Edona Mollo</u> | 26. _____ |
| 12. <u>Allina Livadhi</u> | 27. _____ |
| 13. <u>Mirela Vasija</u> | 28. _____ |
| 14. <u>Samyel Seferi</u> | 29. _____ |
| 15. <u>Mork Bisi</u> | 30. _____ |
| | 31. _____ |